

DEKRET
Nr.164, datë 3.4.1992

PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË UDHËTARËVE

Në mbështetje të nenit 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", si dhe me propozimin e Këshillit të Ministrave,

DEKRETOJ:

Neni 1

Udhëtarët që lëvizin me automjete, hekurudhë dhe anije shtetërore e private, i shtrohen sigurimit të detyrueshëm nga aksidentet.

Primi i sigurimit përfshihet në vleftën e biletës dhe paguhet nga udhëtarët.

Këti sigurimi nuk i nënshtrohen udhëtarët që lëvizin me automjete të transportit urban.

Neni 2

Drejtuesit e mjeteve të transportit janë të detyruar të pajisin udhëtarët me bileta udhëtimi.

Shkelja e mësipërme, kur nuk formon vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet nga punonjësit e organeve të kontrollit të Ministrisë së Transporteve me gjobë nga 50 gjer në 5000 lekë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij, te kryetari i degës së policisë financiare të rrethit, akti i të cilit është i formës së prerë.

Neni 3

Kushtet, objektet rreziqet dhe primet e sigurimit caktohen me rregullore nga Ministri i Financave.

Neni 4

Ministria e Financave dhe Ministria e Transporteve caktojnë rregulla të veçanta për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

PPRESIDENTI REPUBLIKËS
Ramiz Alia